Procesverbal

nga Kuvendi i Punës - Zgjedhor i FSSHRK-së

Mbajtur në Sllatinë më 28.09.2024

KUVENDI I PUNËS

Rendi i ditës:

1. Verifikimi i mandateve nga komisioni i formuar në përbërje:
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit të Kuvendit të datës 07.10.2023
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i raportit të punës mes dy Kuvendeve
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i raportit financiar dhe i auditimit në mes të dy Kuvendeve
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i raportit mbikëqyrës.

- Mbledhjen e hapi kryetari i Federatës së Sportit Shkollor z.Adrian Telaku i cili i përshëndeti delegatët e pranishëm në këtë kuvend, gjithashtu edhe mysafirët prezent z.Fikret Shatri nga MKRS-ja dhe z.Agron Mala nga Komiteti Olimpik.
  Fillimisht kryetari kërkoj tri propozime për verifikimin e mandateve ku nga delegatët prezent u propozuan këta tre anëtarë:
  - Yll Maloku
  - Vllaznim Shabani
  - Besart Ismajli
- Komisioni për verifikimin e mandateve pas verifikimit të listës dhe autorizimeve të delegatëve prezent konstaton se nga 20 delegatë me të drejt vote, prezent janë 19 prej tyre, mungon vetëm përfaqësuesi i Sportit Shkollor nga Klina, dhe prezent është edhe përfaqësuesi i Sportit Shkollor nga Rahoveci, por pa të drejtë vote.
  Komisioni konstaton se janë plotësuar të gjitha kushtet dhe se Kuvendi mund ta fillojë punën.
- Fjalën përshëndetëse e muar z.Fikret Shatri i cili i përshëndeti të pranishmit në këtë Kuvend të punës dhe zgjedhor, i përgëzoj pedagogët për punën e tyre të bërë gjatë këtij viti, i përgëzoj kryetarin dhe bordin për punën dhe transparencën gjatë gjithë kohës dhe ju dëshiroj punë të mbarë në Kuvend.
- Të pranishmit i përshëndeti përfaqësuesi i Komitetit Olimpik të Kosovës z. Agron Mala ku i përgëzoj anëtarët e Federatës së Sportit Shkollor për punën e bërë për këtë periudhë dhe për punën që po bëhet me programin “Sport në Shkolla”, tha se ndihem i privilegjuar me praninë time në monitorimin e kuvendit tuaj dhe besoj se do të kalojë në formën më të mirë të mundshme, ju uroj suksese.

- Para fillimit të punimeve të Kuvendit, kryetari foli rreth çështjes së 5 shoqatave të cilat nuk kanë arritur të licencohen, ato janë: Sporti Shkollor Mitrovicë, Obiliq, Deçan, Junik

dhe Rahovec, jo për fajin e tyre, por për shkak se komisioni për licencim në MKRS-ë nuk është takuar që një kohë të gjatë, e që pritet që të takohen gjatë ditëve në vijim dhe se shumë shpejt edhe këto shoqata do të licencohen.

- Më pas kryetari e propozoj rendin e ditës i cili u aprovua nga të gjithë të pranishmit.

-II-

Në pikën e dytë të rendit të ditës ishte Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit të Kuvendit të kaluar të mbajtur më datë 07.10.2023, materiali ishte shpërndarë me kohë dhe se nuk kishte asnjë vërejtje. **Aprovohet Procesverbali pa vërejtje**.

-III-

Pika e radhës ishte Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit të Punës për periudhën në mes të dy Kuvendeve. Kryetari në pika të shkurta foli për punën e bërë për këtë periudhë, garat shkollore, angazhimet e mëdha me dy projektet shtetërore Drejt Malit – Hiking dhe Skijim, organizimin për herë të parë të gjimnaziadës dhe e hapi diskutimin për raportin e punës.

Vllaznim Shabani.- e ceku një gabim teknik të bërë në raport nga regjioni i Mitrovicës ku foto në raport nuk është e asaj shkolle nga regjioni i tij, por që ky gabim teknik në raportin përfundimtar të përmirësohet.

Pasi nuk kishte asnjë diskutim tjetër nga të pranishmit, kryetari kërkoj ta aprovojmë edhe raportin e punës. **Aprovohet Raporti i punës nga të gjithë pranishmit.**

-IV-

Në rend dite ishte shqyrtimi dhe aprovimi i raportit financiar, ku kryetari z.Telaku foli për procesin e përpilimit të raportit, shpenzimet që janë bërë për këtë periudhë, dhe se vonesa na ka bërë përpilimi i raportit të auditorit që ka qenë edhe shkak për vonesën e mbajtjes së këtij kuvendi. Kërkoj nga të pranishmit nëse kanë ndonjë vërejtje apo ndonjë informatë që ju intereson rreth shpenzimeve të buxhetit, jam i gatshëm tju shpjegoj deri ne detale çdo shpenzim. Pasi raporti nuk patë asnjë vërejtje. **Aprovohet Raporti Financiar nga të gjithë të pranishmit.**

-V-

Pika e pestë i takon Raportit të Këshillit Mbikëqyrës, i cili konstaton se ka pasur bashkëpunim shumë të mirë me organet e federatës, dhe se kanë pasur në dispozicion të gjithë materialin e kërkuar, dhe se raporti i shpenzimeve të federatës është në përputhje të plot me raportin e Auditorit. **Edhe raporti i Këshillit mbikëqyrës u aprovua pa asnjë vërejtje**

Kjo ishte edhe pika e fundit e Kuvendit të Punës, Kryetari i deritashëm i falënderoj delegatët dhe mysafirët prezent, dhe ju kërkoj një pushim 15 minutash dhe do të vazhdojmë me kuvendin zgjedhor.

KUVENDI ZGJDHOR

Rendi i ditës:

6. Zgjedhja e trupave punues:
   6.1 Kryesisë së punës
   6.2 Komisionit verifikues
   6.3 Procesmbajtësi
7. Propozimi i kandidatëve për Kryetar të FSSHRK-së
8. Votimi për kryetar të FSSHRK-së
9. Zgjedhja e anëtarëve të Bordit të FSSHRK-së (nga regjionet)
10. Zgjedhja e Këshillit Mbikëqyrës të FSSHRK-së
11. Të ndryshme

-VI-

Këtë pjesë të kuvendit zgjedhor e udhëhoqi delegati më i vjetër pjesëmarrës në këtë Kuvend, prof Skender Ramadani, i cili i përshëndeti të pranishmit dhe e falënderoj kryetarin e federatës dhe anëtarët e bordit të FSSHRK-së për punën e mirë që e kanë bërë për këtë mandat.
Pastaj kërkoj nga delegatët prezentë që a janë të pajtimit që Komisioni për verifikimin e mandateve që ishte në kuvendin e punës ti verifikojnë mandatet edhe në Kuvendin Zgjedhor, dhe nga të gjithë të pranishmit u dakorduan që të mbetet i njëjti komision në përbërje: Yll Maloku, Vllaznim Shabani dhe Besart Ismajli.

Komisioni konstaton se nga 20 delegatë me të drejtë vote 20 janë prezent dhe janë plotësuar të gjitha kushtet që Kuvendi të vazhdon me punën.

Prof Skender Ramadani foli për kandidimin për kryetar të FSSHRK-së tha se në kohën e paraparë për kandidim nuk është paraqitur asnjë kandidat, kurse në emër të Bordit të Federatës së Sportit Shkollor e propozoj për kryetar të Federatës së Sportit Shkollor kryetarin e deritashëm prof Adrian Telaku. Më që nuk kishte kandidat tjetër propozimi i Bordit të Federatës u hodh në votim.

PËR.- votuan 20 delegatë

KUNDËR.- ASNJË VOTË

ABSTENIM.- ASNJË VOTË

Dhe udhëheqësi i kuvendit prof. Skender Ramadani konstatoj se me votim të hapur dhe me votat e të gjithë të pranishmëve kryetar i Federatës së Sportit Shkollor edhe për një mandat 4 vjeçar u zgjodh prof. Adrian Telaku.

Kryetari në fjalën e tij falënderuese për delegatët për besimin e dhënë, i falënderoj gjithashtu të gjithë për bashkëpunimin, dhe se meritat për ngritjen e federatës në këtë nivel janë të përbashkëta, dhe se nuk do të ndalemi së punuari në të mirë të sportit shkollor.
Ai tha se Federata e Sportit Shkollor ka status të veçantë në MKRS-ë dhe me ligjin e sportit, në MASHT me Udhëzimet Administrative, dhe tha se na nevojitet nga një takim me drejtorët e DKA-ve dhe të DKRS-ve për t'ju treguar se Federata e Sportit Shkollor është organizata e vetme që ka të drejtën për organizimin e garave shkollore, dhe tu kërkohet përkrahja më e madhe për Shoqatat e sportit shkollor nëpër komuna.

Në fund fjalën ja dha Dren Marselit, menaxher i projektit "Sport në shkolla" për ta prezantuar në pika të shkurta këtë program, që vitin e kaluar ishte pilotuar në dy sporte Shah dhe Basket 3x3, kurse këtë vit do të bashkohen edhe tri sporte të reja, Volejbolli, Hendbolli dhe Atletika.
Garat republikane të këtyre garave ishin mbajtur në Prishtinë Basketi 3x3, kurse Shahu në Gjakovë. Të përfshirë në program ishin afërsisht 2000 nxënës.

Blerim Gashi.- nga Sporti shkollor Prizren.- e ceku një problem që ishte përzgjedhja e shkollave pjesëmarrëse në program, dhe përzgjedhja e mësimdhënësve të angazhuar në këto sporte. Kërkoj nga federata që të mbrohen më shumë të drejtat e sportit shkollor nëpër komuna.

Sami Millaku.- nga Sporti Shkollor Klinë.- edhe ky si parafolësi ceku problemin e njëjtë me përzgjedhjen e shkollave po ceku se Drejtoria Komunale e Arsimit i ka përzgjedhur shkollat në bazë të preferencave të tyre.

Kryetari z. Adrian Telaku ju kthej përgjigjen se me qarkoren e lëshuar nga MASHT-ë, ju ka dhënë e drejta e përzgjedhjes se shkollave DKA-ve, kjo ka qenë edhe njëra ndër dobësitë e këtij programi, por që këtë vit shkollor do të ndërroj forma e përzgjedhjes së shkollave, do të ketë thirrje për aplikim nga MASHT-i dhe se shkollat mund të aplikojnë vetë.

-VII-

Pika e radhës ishte propozimi dhe votimi i përfaqësuesve të regjioneve nga shtatë regjionet e Republikës së Kosovës.

Propozimet nga regjionet ishin këto:

Regjioni i Prishtinës – Gazmend Ahmeti

Regjioni i Mitrovicës – Ruzhdi Koca

Regjioni i Pejës – Labinot Metaj

Regjioni i Prizrenit – Rudina Berisha

Regjioni i Ferizajt – Yll Maloku

Regjioni i Gjilanit – Milot Haziri

Regjioni i Gjakovës – Leonard Cula

Kryetari i qiti në votim si paketë të gjitha propozimet nga regjionet përkatëse, dhe me 20 vota PËR nga të gjithë të pranishmit, këta përfaqësues u zgjodhën anëtarë të Bordit të FSSHRK-së.

-VIII-

Në pikën e radhës kryetari kërkoj propozimet për nënkryetar të Federatës së Sportit Shkollor, falënderoj nënkryetaren e deritanishme zinj. Lejla Boshnjak për punën dhe kontributin e saj në këtë pozitë, dhe kërkoj nga delegatët prezentë të propozojnë emrat për nënkryetarin e ri të FSSHRK-së.

Yll Maloku.- nga Sporti Shkollor Ferizaj.- propozoj për nënkryetar prof. Skender Ramadani

Vllaznim Shabani.- nga Sporti Shkollor Vushtrri.- propozoj për nënkryetar prof. Afrim Selimi.

Sipas Statutit të FSSHRK-së votimi duhet të jetë i hapur vetëm nëse kuvendi voton ndryshe, dhe kryetari e qiti në votim dhe se kuvendarët votuan që votimi të bëhet me vota të fshehta.

Komisioni verifikues në përbërje: Yll Maloku, Vllaznim Shabani dhe Besart Ismajli për përgatitjes dhe procesit të votimit konstatuan:

Prof. Skender Ramadani 17 vota,

Prof. Afrim Selimi 3 vota, dhe konstatuan se nënkryetari i ri i FSSHRK-së për mandatin e ri 4 vjeçar u zgjodh **prof. Skender Ramadani.**

-IX-

Rendi i erdh përzgjedhjes së anëtarëve të Komisionit Mbikëqyrës, ku kryetari kërkoj propozimet nga të pranishmit, propozimet për anëtar të këtij këshilli ishin:

- **Basri Jashari**
- **Ganimete Hajdari dhe**
- **Dibran Kastrati**

Këta tre propozime kryetari i hodhi në votim dhe e murrën përkrahjen e të gjithë delegatëve prezentë.

-X-

Në të ndryshme u diskutuan disa çështje, prof. **Sami Millaku** nga Sporti Shkollor Klinë, diskutoj rreth mospjesëmarrjes së nxënësve nga komuna e Klinës në projektin "Drejt Malit – SKIJIM" ku pengesa kryesore është kuvendi komunal Klinë, dhe se për bindje politike, fëmijët e kësaj komune po sanksionohen.

Fikret Shatri.- në fund replikoj me kolegun nga Prizreni rreth përzgjedhjes së shkollave pjesëmarrëse, dhe tha se të gjitha të drejtat për përzgjedhje i kanë takuar DKA-ve komunale.

Në fund kryetari i falënderoj të gjithë të pranishmit për kohen dhe kontributin e tyre gjatë këtij kuvendi.

Kuvendi përfundoj në ora 12:35

Kryetari i FSSHRK-së
Adrian TELAKU

FEDERATA E SPORTIT SHKOLLOR REPUBLIKA E KOSOVËS
FSSHRK
REPUBLIC OF KOSOVA SCHOOL SPORTS FEDERATION

Procesmbajtës:
Leonard CULA